



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 35

Datë: 26. 11. 2022. Ora: 13:00

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kreshnik Radoniqi, kryetar i KQZ-së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Alim Rama, Arianit Elshani, Sami Hamiti, Ilir Gashi, Ibrahim Selmanaj, Rifat Krasniq, Gordana Llaban, Čemailj Kurtiši, Fazli Stollaj.

SKQZ: Burim Ahmetaj, kryeshef.

ZRPPC: Vesa Xharra, drejtoreshë u.d., e ZRCKFSP

Përkthyes: Argjina Misini; Jehona Cami

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

- 1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së**
- 2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së KQZ-së Nr.31 dhe 32 /2022**
- 3. Aktivitetet e SKQZ-së**
- 4. Raport për Aktivitetet e ZRCKFSP**
- 5. Raport i Këshillave të KQZ-së:**
 - Këshilli për Buxhet dhe Financa**

-Shqyrtimi dhe miratimi i buxhetit për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendet e Komunave: Zveqan dhe Lepasaviq.

Këshilli për Operacione Zgjedhore

-Shqyrtimi dhe miratimi i Planit Operacional për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendet e Komunave: Zveçan dhe Leposaviq.

Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për caktimin e afateve të aktiviteteve zgjedhore për zgjedhjet të parakohshme për Kuvendet e Komunave: Zveçan dhe Leposaviq.

RENDI I DITËS

1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:

Kreshnik Radoniqi: E hapim mbledhjen e 35, jemi prezent të gjithë veç, Sami Kurteshit që do të na bashkohet përmes platformës online.

Arianit Elshani, tha se nuk janë përfshirë nga Sekretariati "rishikimi i planit të Informimit" lidhur me zgjedhjet në katër komnat, dhe "rishikimi i planit të informimit" për kuvendet komunale – në dy komnat, si dhe "shqyrtimi i specifikave të Fletëvotimit". Pra, këto të miratohen...

Kreshnik Radoniqi: Të futen pra edhe këto tri pika në rendin e ditës ! Atëherë kush është për...?

Me 11 vota për, miratohet rendi i ditës, pastaj po me 11 vota miratohet procesverbali nga mbledhja nr. 31/2022. Nuk aprovohet procesverbali nr. 31, dhe mbetet që të plotësohet, meqë është mbajtur takimi përmes imellave....!

Alim Rama, tha se lidhur me procesverbalin 31, duhet të ceket, se unë kam qenë kundër datave të afateve. Dhe, mandej kërkesa ime është ndërlidhur me krejt diçka tjetër: me kërkesa teknike që nuk kanë pasur të bëjnë fare me këtë çështje... Në të ardhmen, komunikimet e brendshme teknike nuk ka nevojë të politizohen, dhe të bëhen publike...

2. Aktivitetet e SKQZ-së

Burim Ahmetaj, tha se në kuadër të përgatitjeve për Zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar të Komunave në Komnat: Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok, Leposaviq dhe Zveçan, që do të mbahen me

datën 18 dhjetor 2022, sipas Planit Operacional për Zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar të Komunave në Mitrovicë të Veriut, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok, që do të mbahen me datën 18.12.2022, periudha e regjistrimit për votuesit me nevoja të veçanta – Kategoria e parë e VPNV-ve, fillon me datën 26.11.2022 dhe përfundon me datën 01.12.2022.

Ky aktivitet, informoi z. Ahmetaj, përmban regjistrimin e personave me Nevoja të Veçanta, që ka të bëjë me evidentimin e votuesve me të drejtë vote, të cilët për shkak të paaftësisë fizike, shëndetësore ose çfarëdo paaftësie tjetër nuk mund të dalin nga shtëpitë e tyre për të votuar personalisht në Vendvotimin e zakonshëm. Mirëpo me situatën aktuale në komunat në të cilat organizohen zgjedhjet, edhe pse kemi plotësuar pozitat e zyrtarëve të dorëhequr me ushtrues detyre, akoma Sekretariati i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nuk ka qasje në zyre dhe në objektet në të cilat janë të vendosura zyrat e Zyrtarëve të Lartë Komunal të Zgjedhjeve në të katër Komunat. Fushëveprimi i u.d, është duke u bërë nga zyrat e vendeve të tyre të punës. Sekretariati ka njoftuar dhe shpërndarë kontaktet e u.d për secilën komunë tek Subjektet Politike dhe organizatat civile që veprojnë në ato komuna mirëpo me situatën aktuale në terren ky aktivitet do të has në vështirësi në zbatimin.

Për këtë periudhë përgatitore, në ueb faqen e KQZ-së, janë publikuar të gjitha informatat e nevojshme, duke përfshirë formularin e aplikimit po ashtu është dërguar njoftimi për tu transmetuar në RTK1, RTK2, RTK3 dhe publikimin në portalin dhe rrjetet sociale të RTK-së. Me datë 24 nëntor 2022, Sekretariati i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ka kërkuar nga KGJK, të dhënat personale të personave/qytetarëve që u është marrë zotësia e veprimit me vendim të prerë gjyqësor nga Gjykatat kompetente të Republikës së Kosovës

Periudha e aplikimit/regjistrimit për votim përmes postës do të fillojë nga data 26 nëntor - 30 nëntor 2022, vetëm për qytetarët që jetojnë jashtë vendit dhe që kanë dëshmi të vendbanimit në komunat: Mitrovicë të Veriut, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok.

Kryeshefi Ahmetaj, po ashtu potencoi se, bazuar në Planin Operacional për Zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar të Komunave në Mitrovicën e veriut, Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan, që do të mbahen me datën 18.12.2022, Periudha e aplikimit për regjistrim të votuesve jashtë Kosovës, ka filluar sot, me datën 26.11.2022 dhe do të përfundoj me datën 30.11.2022.

Lidhur me përgatitjet për këtë periudhë, Sekretariati i KQZ-së: Ka funksionalizuar linjat telefonike ndihmëse, dhe llogaritë elektronike (e-mailat) për këtë shërbim; Të gjitha informatat janë publikuar në ueb faqen e KQZ-së; Me datën 25.11.2022, shërbimi i votuesve ka dërguar e- mailat njoftues dhe

aplikacionet për 66 votues të cilët kishin aplikuar suksesshëm për regjistrim për votim jashtë vendit në Zgjedhjet Lokale 2021. Pra, janë dërguar aplikacione për regjistrim për votim jashtë Kosovës:

56 votuesve jashtë Kosovës, të komunës së Zubin Potokut,

2 votuesve jashtë Kosovës, të komunës së Zveçanit,

8 votuesve jashtë Kosovës, të komunës së Mitrovicës së Veriut.

Po ashtu, tha z. Ahmetaj, Sekretariati është në fazën e zhvillimit të procedurave për furnizime dhe shërbime. Me shpalljen e datës së zgjedhjeve të parakohshme për kuvendin komunal në komunat Zveçan dhe Leposaviq, për shkak të natyrës së njëjtë do t'i zhvillojë së bashku aktivitet e prokurimit për mallra dhe shërbime për zgjedhjet për kryetar komune dhe kuvendin komunal. Gjithashtu, në përputhje me detyrimet që dalin nga Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe Ligji për zgjedhjet Lokale, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është në fazën e themelimit të trupave zgjedhore (Komisionet Komunale të Zgjedhjeve – KKZ), në secilën prej këtyre komunave, periudhë e cila përfundon me datë 28 nëntor 2022.

Diskutime dhe pyetje lidhur me raportin e Sekretariatit:

Ilir Gashi, tha se edhe në mbledhjet e kaluara është ngritur çështja e sigurisë, kemi kërkuar që të komunikojmë më institucionet tjera. Kryesuesi, është mirë që ta marrë këtë barrë dhe të komunikoj me ministrinë e brendshme, me ministrinë e arsimit sepse, ne i organizojmë zgjedhjet por sigurinë nuk e implementojmë ne! Janë institucionet relevante që i krijojnë kushtet për një proces të sigurve, e pastaj edhe demokratik. Sa më parë, ju z. kryesues me kryeshefin t'i vini kontaktet me këto institucione, sepse hapja e Qendrave të Votimit duhet të garantohet nëse dëshirojmë të mbahen zgjedhjet në datat e caktuara...

Nëse, ne i themelojmë qendrat e votimit për datën 18 dhjetor dhe ato nuk hapen, cila është esenca ? A ka qendra alternative, apo janë ato të mëhershmet ?

Është mirë të sigurohemi, konsideroj që të bëhet komunikimi dhe ne detyrat tona i kryejmë. Ne, duhet me pas një pasqyrë të qartë me gjendjen që na pret...

Ibrahim Selmanaj: E ndaj të njëjtin mendim, ne qëndrojmë mirë me planin por në terren duhet të kihet parasysh situata në terren. Duhet të ketë komunikim dhe koordinim me institucionet e caktuara, madje edhe me mekanizmat ndërkombëtarë...

Sami Hamiti: Realisht, këto që u thanë në çdo palë zgjedhje janë nënshkruar memorandume me institucionet. Secila nga institucionet, e ka marrë barrën e vet. Ne, do të mbërrim në një situatë, pashmangshëm, ku do të bllokohemi: shkollat, drejtoritë e shkollave nuk punojnë...Pra, duhet insistim dhe kontakt që të nënshkruhen memorandumet, dhe secila ta marrë barrën e vetë... Ne, po punojmë, por askush s'po merret me ne...!

Sami Kurteshi: Sido qoftë, zyrtarët komunal zgjedhor e kanë për obligim që kur tërhiqen të bëhet pranim-dorëzimi i zyrave. Ata, janë të obliguar ti dorëzojnë mjetet, dokumentet etj. S'i është me shkollat nuk e di, por bashkëpunimi me organet e tjera duhet të bëhet. Tash, kemi një situatë të veçantë dhe, takimi duhet të bëhet...

Arianit Elshani: Para dy ditësh, ne edhe zyrtarisht kemi pranuar aktet e dorëheqjeve, pavarësisht se më parë ne i kemi refuzuar... Këto dorëheqje, janë zyrtare, të protokolluara...! Ushtruesit e detyrave, duhet të tentojnë të shkojnë në ato zyre dhe të përfundohet ky proces i dorëzimit - pranimi, por të shkojnë me policinë për tu siguruar por, edhe me drejtorët e shkollave sepse ata janë edhe menaxher të qendrave të votimit... Veprimet tona, duhet të jenë mirë të koordinuara...pa këtë, rrezikohet gjithçka...

Kreshnik Radoniqi: Na duhet një vlerësimi i MPB...ne, nuk kemi qasje atje në zyrat tona, asht një situatë specifike por, ti lëmë të vendosin ato...

Čemailj Kurtiši: Unë, mbështesë gjithë këtë që u tha, dhe mendoj që duhet ta rrisim seriozitetin në mënyrë që pastaj askush të mos ketë arsye të na kritikoj...si KQZ...! Duhet që sa më shumë ta rrisim komunikimin me institucionet, madje edhe me ato ndërkombëtare sepse nuk duhet të lejojmë që zgjedhjet të na dështojnë! Nuk kemi nga raportet e Sekretariati ndonjë lëvizje në këtë drejtim, kurse për disa çështje ne duhet të vendosim qysh sot, nuk kemi plan A, ndërsa që duhet të kemi edhe plan B sepse, edhe nëse nuk kemi memorandum shteti duhet të veprojmë...

Gordana Llaban: Pajtohem me këto që u thanë dhe s'dua të përsëritëm, por nëse duhet të kërkojmë qendra alternative duhet të llogarisim që ato t'i plotësojnë disa kushte, së paku disa kushte praktike...

Alim Rama, tha se në raportet e krye shefit nuk kemi pas kësi shenja, kontakti me institucionet duhet të vendoset menjëherë; tash formalisht i kemi dy data të zgjedhjeve, dhe ne duhet të kemi raporte mbi proceset për të dy këto zgjedhje...

Kurse, mbasi që janë formalizuar dorëheqjet, mendoj që urgjent duhet ti shpallim konkurset për plotësimin e atyre katër vendeve të lira të punës...nuk kemi nevojë të presim shumë, natyrisht sipas ligjit të veprimë...

Sami Kurteshi, menjëherë duhet të bëhet pranim – dorëzimi i zyrave, e kemi edhe memorandum që i ndryshon rrethanat...Unë mendoj që KQZ që të kërkohet nga Ministria e Arsimit që të gjitha shkollat që kanë shërbye si Qendra të Votimit të sigurohen me kohë...

Në këtë pikë, diskutuan më tej: Ilir Gashi, Kreshnik Radoniqi, Burim Ahmetaj, Sami Hamiti dhe Čemailj Kurtiši.

3.Raport për Aktivitetet e ZRCKFSP

Vesa Xharra, u.d., e drejtorit të ZRCKFSP, në raportin e zyrës në mes të dy mbledhjeve, tha se në përputhje me vendimin e KQZ për shtyrjen e afatit të fundit për aplikim për certifikim për pjesëmarrje në Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar Komune në Leposaviq, Zubin Potok, Zvečan dhe Mitrovicë e Veriut, Zyra ka pranuar aplikimet deri më 25 nëntor në ora 16:00. Deri në përfundim të afatit, kanë aplikuar subjektet politike:

Për komunën e Leposaviqit kanë aplikuar tri (3) subjekte politike: Partia Demokratike e Kosovës; Partija Kosovskih Srba; Lëvizja Vetëvendosje

Për komunën Zubin Potok kanë aplikuar dy (2) subjekte: Partia Demokratike e Kosovës; Lëvizja Vetëvendosje.

Për komunën Zvečan kanë aplikuar tri (3) subjekte politike: Partia Demokratike e Kosovës; Kandidat i pavarur; Lëvizja Vetëvendosje.

Për komunën e Mitrovicës së Veriut kanë aplikuar katër (4) subjekte politike: IQ Mitrovica; Partia Demokratike e Kosovës; Lëvizja Vetëvendosje; GI Srpski Opstanak.

Zyra, siç e informoi KQZ-në Xharra, ka filluar edhe verifikimet e kandidatëve në përputhje me kriteret të definuara në nenin 29 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme duke dërguar listën e kandidatëve që kanë aplikuar në tetë (8) institucione për ti bërë verifikimet e nevojshme.

Diskutime dhe pyetje lidhur me raportin e ZRCKFSP:

Ilir Gashi: A planifikoni me pas ndonjë takim me subjektet politike, dhe kur...?

Vesa Xharra: Praktikisht, sot fillon të rrjedh afati. Zyra, i ka afatet e reja sa i përket certifikimit të këtyre zgjedhjeve të jashtëzakonshme, dhe ne jemi duke mbajtur kontakte të rregullta me subjektet përmes shkresave.

4. Raport i Këshillave të KQZ-së:

1.Këshilli për Buxhet dhe Financa

Shqyrtimi dhe miratimi i buxhetit për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendet e Komunave: Zveqan dhe Lepasaviq:

Gordana Llaban: Këshilli ka mbajtur takimin e 14-të, dhe kemi shqyrtuar planin e buxhetit për zgjedhjet e parakohshme për kuvendet e komunave Zveqan dhe Lepasaviq. Pas shpalljes së këtyre zgjedhjeve, Sekretariat ka përgatitur planin, dhe ne e kemi shqyrtuar. Ju e keni raportin në imella. Ky plan përfshinë një buxhet prej: 64, 177 euro.

Diskutime dhe pyetje lidhur me raportin e ZRCKFSP:

Alim Rama, besoj që është e qartë se ky buxhet, nuk i përfshinë pagesat e trupave zgjedhor (KVV) sepse, për shkak të mbylljes së vitit fiskal pagesa kryhet vitin tjetër. Kisha kërkuar prej Sekretariatit që pagesat të bëhen menjëherë me fillimin e vitit tjetër...

Arianit Elshani, tha se ndoshta “çështja e këtyre pagesave” ka nevojë edhe pak të shqyrtohet nga këshilli për personel, sepse mendoj që pagesat janë shumë të ulëta...Mendoj që ka nevojë për trajtim, këto pagesa janë absurde...

Kreshnik Radoniqi: Kush, është për...?

Me 10 vota për, 1 abstenim – aprovohet.

2. Këshilli për Operacione Zgjedhore

1.Shqyrtimi dhe miratimi i Planit Operacional për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendet e Komunave: Zveqan dhe Lepasaviq:

Arianit Elshani: KOZ, ka shqyrtuar këtë plan. Këtë plan, ne jemi munduar që ta koordinojmë edhe me planin operacional të zgjedhjeve për kryetar të komunave në mënyrë që të mos kemi hedhjen e shortit të dyfishtë në mënyrë që një subjekt politik, të ketë një “numër” tjetër në garë për kryetar të komunave dhe një “numër” tjetër në garë për kuvende komunale. Në të njëjtën ditë, ne planifikojmë të hidhet shorti edhe për kryetar komune dhe për asamblistë komunalë. Në të njëjtën mënyrë gjykojmë të jetë edhe fushata zgjedhore, pra në ditën e përfundimit të zgjedhjeve për kryetar komune që i bie nga data: 19 dhjetor – deri më 23 dhjetor. Edhe çështja e fletëvotimeve, është sinkronizuar!

KOZ, rekomandon që të aprovohet ky plan.

Me 10 vota për, miratohet ky plan operacional.

2.Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për caktimin e afateve të aktiviteteve zgjedhore për zgjedhjet të parakohshme për Kuvendet e Komunave: Zveçan dhe Leposaviq:

Arianit Elshani: Janë afate nga plani operacional që sapo u miratuan, dhe besoj që do njoftohen edhe subjektet politike, si dhe opinionit ! I keni në raport, dhe ne rekomandojmë për aprovim.

Alim Rama, tha se lidhur me këto dy pika, pra lidhur me planin është një pajtueshmëri e plotë në KOZ.

Arianit Elshani, tha se si njoftim lidhur me “KKZ”-të dhe me çështjen e “Komisionarëve” që, Sekretariati dhe Zyra ti kryejnë konfirmimet për ato subjektet politike që janë në garë, që të mos kemi veprime të dyfishta...Po ashtu, edhe “Qendrat e Votimit” të njëjtat vlejnë për datën 18 dhe 25...

Me 11 vota për, miratohet ky plan operacional.

Kreshnik Radoniqi: A ka dikush diçka tjetër...?

3.Shqyrtimi dhe miratimi i rishikimit të Planit të informimit lidhur me Zgjedhjet për Kryetar të Komunave në komunat, Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok, Leposaviq dhe Zveçan, dhe për Zgjedhjet e Kuvendeve Komunale në Leposaviq dhe Zveçan:

Arianit Elshani: Për shkak të procedurës së prokurimit që do të përfundoj diku më 5 dhjetor lidhur me Informimit Publik, në e kemi rishikuar planin, dhe do të heqim disa video spote që kemi kërkuar të hiqen...Dhe, ai buxhet, të bartet në planin e këtyre zgjedhjeve...

Gjithashtu, e kemi rishikuar edhe planin për informim... Disa materiale që bëhen me pagesë i kemi shtyrë, kurse të tjerat, ato në rrjetet sociale do të vazhdojnë...

Alim Rama: Duhet ta kemi parasysh se kur janë gjuhët e komuniteteve, në këtë rast, për shembull votues turk nuk ka atje, më duket nja 10 votues kanë qenë në zgjedhjet e kaluara...kështu që, pse të bëhen shpenzime...

Atëherë, e hedh në votim...?

Me 10 vota për, miratohen këto dy plane.

4.Shqyrtimi dhe miratimi i rishikimit të specifikave të Fletëvotimit:

Arianit Elshani: KOZ ka shikuar edhe specifikat lidhur me fletëvotimit për kryetar dhe për kuvende komunale. Para se të nënshkruhet vendimi, duhet të rishikohen...Ka ndryshime në formatin e fletëvotimit, dhe ne kemi kërkuar zvogëlimin e tyre: formati A/5 të jetë për kryetar të komunave, dhe formati A/4 të jetë për anëtarët e kuvendeve.

Sasia është rreth 8% më e lartë se numri i votuesve, që pastaj do të ndahet në proporcion me numrin e votuesve.

Ne prandaj, rekomandojmë për miratim.

Miratohet me 10 vota për, edhe ky rekomandim.

Të ndryshme !

Kreshnik Radoniqi: Po pyes, a kemi ne pare për me rregullue sistemin në mënyrë që të kemi mundësi teknike që, ndonjëherë t'i mbajmë mbledhjet, kur kemi nevojë: on line...? Ku do i kanë rregullue, ne se kemi...!